

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Subjekti: P.F “NIKOS SEMANJAKOS”

Adresa e zyres qendrore: Fier ZHAREZ SHEQISHTE Fshati Sheqishte. Banesa te Grupi i Naftes

Administrator: Nikos Semanjakos

NUIS- L03414401Q

**RAPORTI TEKNIK PER FAZEN E NJOFTIMIT PER FILLIM
PROCEDURE**

INSTALIM INCENERATORI

Sipas Shtojces I, Pika 9

Instalime për asgjësimin e mbetjeve për incinerimin, trajtimin kimik, sipas seksionit D9, ose venddepozitimet e mbetjeve të rrezikshme, siç përcaktohet në ligjin “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”

**Fier MBROSTAR URA MBROSTAR URA Fshati Mbrostar Ura,
Rruga Fier- Kallm km 2, Ndertesa ZK 2636, nr pasurie 63/22**

HARTOI RAPORTIN

EKSPERT I LICENSUAR:

PASQYRA E LENDES

- a. Qellimi i projektit te propozuar
- b. Planimetria e vendodhjes se projektit, ku te pasqyrohen ne harte topografike kufijte e siperfaqes se tokes se kerkuar, te shoqeruar me koordinatat sipas sistemit GAUSS KRUGER, fotografi dhe te dhena per perdorimin eksistues te siperfaqes se tokes qe do te perdoret perkohesisht apo perhere nga projekti gjate fazes se ndertimit apo instalimit te pajisjeve
- c. Informacion per qendrat e banuara, ne zonen ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar me fotografi dhe te dhena per distancen e tyre nga vendodhja e projektit te propozuar, si dhe percaktimin e njesise se qeverisjes vendore qe administron territorin ku propozohet projekti
- ç. Skicat dhe planimetritet e objekteve te projektit dhe strukturave te projektit
- d. Pershkrim i proceseve ndertimore dhe teknologjike te shfrytezimit te gurit gelqerore me kariere, perfshire kapacitetin prodhues, sasite e lendeve te para dhe produktet perfundimtare te projektit.
- e. Infrastruktura e nevojshme per lidhjen me rrjetin elektrike, furnizimin me uje, shkarkimet e ujerave te ndotura dhe mbetjeve si dhe informacion per rruget ekzistuese te aksesit apo nevojten per hapje te rrugeve te reja
- f. Programi per ndertimin, kohezgjatjen e ndertimit, kohezgjatjen e planifikuar te funksionimit te projektit, kohen e mundshme te perfundimit te funksionimit te projektit dhe sipas rastit edhe fazen e planifikuar te rehabilitimit te siperfaqes pas mbarimit te funksionimit te projektit
- g. Menyrat dhe metodat qe do te perdoren per ndertimin e objekteve te projektit
- h. Lendet e para qe do te perdoren per ndertimin dhe menyra e sigurimit te tyre (materiale ndertimi, uje, energji)
- i. Informacion per lidhjet e mundshme te projektit me projekte te tjera ekzistuese perreth/prane zones te projektit
- j. Informacion lidhur me alternativat e marra ne konsiderate persai takon perzgjedhjes se vendodhjes se projektit dhe teknologjise qe do perdoret
- k. Perdorimin e lendeve te para gjate funksionimit, perfshire sasite e ujit te nevojshme, energjise, lendeve djegese dhe menyren e sigurimit te tyre
- l. Aktivitete te tjera qe mund te nevojiten per zbatimin e projektit, si ndertim i kampeve apo rezidencave etj.
- m. Informacion per lejet dhe licensat e nevojshme per projektin te kerkuara nga legjislacioni ne fuqi si dhe institucionet kompetente per lejimin/licensimin e projektit
- n. kopje te lejeve, autorizimeve dhe licencave qe disponon zhvilluesi per projektin e propozuar, ne perputhje me percaktimet e bera ne legjislacionin ne fuqi, si dhe institucionet kompetente per lejimin/autorizimin/licencimin e projektit.

a. Qellimi i projektit te propozuar

Subjekti“NIKOS SEMANJAKOS” eshte i njohur ne tregun shqiptar per sa i perket produkteve me baze shtazore. Aktiviteti i tij daton qe ne vitin 2010, me shume veprimtari, sipas pershkrimitt te Qendren Kombetare te Biznesit:

“Magazinin, perpunim imputesh bujqesore e blegtorale si dhe rritje e tregtim shpende e kafshe te gjalla me shumice dhe me pakice. Therje, perpunim dhe tregtim të produkteve të mishit, perpunim lëkurash dhe eksporti i tyre.Transporti rrugor kombetar dhe nderkombetare i mallrave per vete, per te trete dhe me qira. Shitje me shumice e ushqimeve me origjine shtazore per njerez. Mbarështimi i kafshëve për majmëri. Bar kafe, restorant. Shitje me pakice. Tregti me pakice dhe shumice e mishit te ngrire. Transporti i lendeve te rrezikshme per veten e vete.”

Ky subjekt eshte gjithnje ne zgjerim te aktiviteteteve te tij. Per shkak te aktivitetit ne fushen e tregetimit te mishit, gjerehohen edhe mbetje shtazore, per te cilat kerkohet nje trajtim me incenerim.

Pas nje komunikimi shkresor me Agjencine Kombetare te Mjedisit, u vendos qe ky projekt i nenshtrohet Procedures se thelluar te VNM, sipas shkreses me poshte:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E LEJEVE MJEDISORE DHE VNM

Nr. 1311 Prot.

Tiranë, më: 12.02 2024

Lënda: Informacion mbi procedurat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

“NIKOS SEMANJAKOS” ✓

Fier, Zharëz, Sheqishtë, Fshati Sheqishtë, Banesa te grupi i naftës. L03414401Q.

Në përgjigje suajës, me Nr. Extra Prot., datë 07.02.2024, regjistruar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit me Nr. 1311 Prot., datë 07.02.2024 lënda “Kërkesë për informacion mbi VNM Paraprake.”, ju bëjmë me dije se:

Në bazë të Ligjit nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, projekti “Incinerimi i mbetjeve duke përfshirë mbetjet e kafshëve në një instalim incinerimi”, përfshihet në *Shtojcën I: Pika 9. Instalime për asgjësimin e mbetjeve për incinerimin, trajtimin kimik, sipas seksionit D9, ose venddepozitimet e mbetjeve të rrezikshme, siç përcaktohet në ligjin “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”*, duhet ti nënshtrohet procedurës së VNM-së.

Aplikimi kryhen në platformën qeveritare “e-Albania”, bazuar në VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjësive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar;

Duke Ju falenderuar,

DREJTORI PËRGJITHSHËM



- :
- b. **Planimetria e vendodhjes se projektit, ku te pasqyrohen ne harte topografike kufijte e siperfaqes se tokes se kerkuar, te shoqeruar me koordinatat sipas sistemit GAUSS KRUGER, fotografi dhe te dhena per perdorimin eksistues te siperfaqes se tokes qe do te perdoret perkohesisht apo perhere nga projekti gjate fazes se ndertimit apo instalimit te pajisjeve.**

KOORDINATAT KU USHTROHET VEPRIMTARIA E NIKOS SEMANJAKOS PER INCENERIM MBETJESH-KRRGJSH


Koordinata KRRGJSH	X	Y
1	466779.74	4513994.06
2	466767.84	4513976.28
3	466797.24	4513960.60
4	466791.92	4513949.96
5	466803.96	4513944.64
6	466819.36	4513971.24

KOORDINATAT KU USHTROHET VEPRIMTARIA E NIKOS SEMANJAKOS PER INCENERIM MBETJESH-ASIG

Koordinata ASIG	X	Y
1	4382468.95	4514984.56
2	4382456.84	4514966.91
3	4382486.07	4514950.90
4	4382480.62	4514940.32
5	4382492.60	4514934.86
6	4382508.31	4514961.29



- c. Informacion per qendrat e banuara, ne zonen ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar me fotografi dhe te dhena per distancen e tyre nga vendodhja e projektit te propozuar, si dhe percaktimin e njesise se qeverisjes vendore qe administroren territorin ku propozohet projekti



Bashkia Fier përfshin zonat bujqësore më të rëndësishme të vendit, si dhe një pjesë të konsiderueshme të industrisë që lidhet me përpunimin e naftës. Më shumë se 55 për qind e popullsisë së Fierit jetojnë në zonat rurale.



Pas implementimit të Reformës Administrativo-Territoriale, në Fier llogaritet një popullsi prej 200,000 banorë, me dendësi 287 banorë/km² dhe sipërfaqe 682,7 km².

Bashkia Fier përbëhet nga 13 Njësi Administrative:

- Njesia administrative "R 1"
 - Njesia administrative "R2"
 - Njesia administrative "R 3"
 - Njesia administrative "R 4"
 - Njesia administrative "Qender"
-
- Njesia administrative "Portez"
 - Njesia administrative "Mbrostar"
 - Njesia administrative "Levan"
 - Njesia administrative "Libofshe"

- Njesia administrative "Dermentas"
- Njesia administrative "Topoje"
- Njesia administrative "Frakull"
- Njesia administrative "Cakran"

Fieri është një qytet në Shqipërinë e jugut rrethit të Fierit. Përsa i përket qytetit të Fierit popullsia e tij pas viteve '90 të shekullit të XX numëronte 40 000 banorë, kurse në ditët e sotme, si rezultat i dyndjes së popullsisë nga rrethi i Mallakastrës dhe nga rrethet veriore të vendit, vlerësohet që popullsia e qytetit të Fierit të ketë arritur në 122 000 banorë. Ndërsa e qarkut 302 mijë banorë. Fieri është një nga qytetet me të zhvilluara. Mbeshtetet në bujqësi dhe blegtori intensive me mjete moderne. 12 km larg qytetit të Fierit, ndodhen rrënojat e qytetit antik të Apolonisë. Qyteti u themelua në vitin 558 p.e.s në një kodër pranë detit dhe afër grykëderdhjes së lumit Aaos (Vjosa) nga kolone të ardhur nga Korinti e Korfuzi. Në lulëzimin e tij mendohet të ketë pasur një popullsi prej 50 000 - 60 000 banorësh. Për rëndësinë ekonomike dhe kulturore dhe për hapësirën e madhe të shtrirjes së tij, Ciceroni e ka quajtur qytet të madh dhe hijerëndë.

Historia e Qytetit

Origjina e qytetit të Fierit shkon në shekullin e VI-të p.e.s. me qytetin antik të Apolonisë (quajtur sipas perëndisë Greke, Apollos). Apolonia ishte qyteti i dytë më i madh Ilir dhe një prej dy pikave të fillimit të Rrugës Egnatia, një prej rrugëve kryesore të Perandorisë Romake dhe asaj të Bizantit. Rruga Egnatia lidhte Romën në Perëndim me Konstandinopojën në Lindje.

Origjina e emrit të Fierit është e diskutueshme, megjithatë shumica e kërkuesve besojnë se emri Fier vjen prej fjalës Italiane “fiera”, që do të thotë panair. Sipas mbështetësve të kësaj teze, ishin tregëtarët Venedikas që e emërtuan qytetin në shekujt 14-të dhe 15-të, kur blinin produktet bujqësore në tregjet e qytetit.

Qyteti u themelua në vitin 1864 kur Kahreman Pasha (guvernatori lokal) u kërkoi disa arkitektëve Francezë të projektonin qytetin e ardhshëm, si qendër tregëtare dhe artizanale në kryqëzimin e rëndësishëm Lushnjë-Fier dhe Berat-Mallakastër-Seman).

Qyteti u projektua sipas Modelit të Qyteteve të Rilindjes Europiane të shekullit të 19-të. Aktiviteti i tij kryesor do të ishte tregëtia e produkteve bujqësore të zonave të Myzeqesë dhe Mallakstrës. Gjatë viteve 1864-1865, një treg u ndërtua përgjatë lumit Gjanica për 122 tregëtarë. Banorët e parë të Fierit ishin shërbëtorët/argatët e Kahreman Pashës si dhe anëtarët e familjeve Vllehe, që kishin jetuar në këtë zonë që prej viteve 1800. Shpejt pas ndërtimit të tregut, Fieri e krijoi statusin e tij ekonomik si një qytet i tregëtarëve dhe zanatçinjve.

Kjo qendër tregëtare u përdor si pikë referimi, edhe prej dy topografëve Italianë Tabolini dhe Momori, që organizuan planin arkitektural të qytetit. Rregjistrimi i parë i popullsisë u zhvillua në vitin 1923 dhe qyteti i Fierit ishte i përbërë prej 5 lagjesh me një total prej 1493 banorësh. Shumë ndryshime demografike ndodhën në qytetin e Fierit ndërmjet fillimit të shekullit të 20-të dhe Luftës së Dytë Botërore. Migrantë nga zonat e Labërisë, Kosovës, Mallakastrës, Beratit dhe Gjirokastrës u vendosën në qytetin e Fierit. Mbas Luftës së Dytë Botërore një numër i madh banorësh prej zonës së Çamërisë migruan në qytetin e Fierit.

Pas Luftës së Dytë Botërore deri në vitin 1991, Fieri u shëndërrua në qendrën e dytë më të madhe ekonomike të vendit, pas Tiranës. Qyteti pati një zhvillim të madh ekonomik dhe disa prej industrive kryesore që u zhvilluan përfshinin Nxjerrjen dhe Përpunimin e Naftës, Ndërtimin, Bujqësinë dhe Përpunimin e Produkteve Bujqësore. Gjithashtu edhe kompleksi më i madh industrial (Kimik, Mekanik dhe Energjitik) u krijua në qytetin e Fierit. Si rezultat, qyteti lulëzoi dhe njerëz prej të gjithë Shqipërisë migruan drejt Fierit. Në vitin 1965 qyteti i Fierit kishte një popullësi prej 20,000 banorësh, në 1982 popullësia ishte rritur në 35000 dhe në 1991 kishte arritur në 48,000 banorë.

Ndryshimi i sistemit politik në vitin 1991, që u parapri prej një kolapsi ekonomik, u pasua prej emigrimit të shumë banorëve të Fierit për në Greqi, Itali dhe vende të tjera, në kërkim të vendeve më të mira të punës. Gjithashtu edhe shumë banorë nga qytetet e tjera, si dhe nga zonat rurale përreth qytetit të Fierit migruan drejt qendrës së Fierit. Këto lëvizje demografike shkaktuan luhatje të numrit të popullsisë. Në vitin 2004, qyteti i Fierit kishte një popullsi prej 83,000 banorësh. Për shkak të kolapsit ekonomik, shumë fabrika, ndërmarrje dhe kompani shtetërore u mbyllën dhe u krijuan prona dhe biznese private.

Ekonomia

Fieri renditet i treti në Shqipëri për nga rëndësia ekonomike. Ka një ekonomi të fuqishme dhe është qendra e Shqipërisë përsa i përket industrive të naftës, bitumit dhe bujqësisë. Fieri ka depozita të mëdha naftë dhe gazi natyral dhe prodhon afërsisht 2800 fuçi naftë për ditë, si dhe 5 milion m³ gaz natyral për vit. Burime të tjera natyrore përfshijnë rërën bituminoze, materialet inerte, dhe argjilën.

Bujqësia është një prej sektorëve më të rëndësishëm. Prodhohen sasi të konsiderueshme gruri, misri, ullinjsh, domatesh, patatesh, rrushi, mollësh, shalqinjsh dhe foragjeresh. Ka gjithashtu një numër të konsiderueshëm shpezësh dhe gjëje të gjallë.

Sektorët kryesorë të ekonomisë së Fierit përfshijnë:

Nxjerrjen dhe Përpunimin e Naftës: kompani shtetërore dhe private, duke përfshirë kompani të huaja;
Ndërtim;

Përpunim Ushqimi: pije freskuese dhe alkolike, vaj ulliri dhe gatimi, mish, nënprodukte të qumështit, bukë, sheqer, miell etj;

Import-Eksport;

Tregëti: rroba, ushqim, elektroshtëpiake etj;

Tekstile dhe prodhim veshjesh;

-Ekonomia

Baseni naftëmbajtës i njohur si “Patos-Marinza” është historikisht zona më e pasur me naftë në Shqipëri dhe sot vijon të prodhojë shumicën dërrmuese të naftës bruto në vendin tonë. Por pavarësisht kësaj, numri i të punësuarve në industrinë e naftës nga kjo zonë është sot shumë herë më i ulët se sa ka qenë dikur.

Për shumë vite burimi kryesor ekonomik ka qenë sektori naftënxjerrës, por pasi kanë nisur operimin në tregun e naftës kompanitë e huaja niveli i të punësuarve në këtë sektor ka ndryshuar, duke sjellë një përqendrim gjithnjë e më të madh tek sektori i bujqësisë dhe agrikulturë. Sipas të dhënave tashmë,

përveç ish komunës Zharrës, zonat e tjera si Patosi dhe Ruzhdia kanë si burim kryesor ekonomik kultivimin e ullirit dhe tregtimin e nënprodukteve të tij, të cilat favorizohen dhe nga vetë relievi kodrinor i kësaj zone.

Turizmi

Parku Arkeologjik i Apollonisë Katedralia e Shen Gjergjit

- ✓ Kisha e Shen Kozmait
- ✓ Pamje nga kodrat e Cakranit
- ✓ Qyteti antik i Gurzezës
- ✓ Laguna e Kernices ne Darzeze
- ✓ Bregdeti i Darzezes dhe i Semanit
- ✓ Manastiri i Shen Merise Hyjllindese (Parku Arkeologjik Apolloni)
- ✓ Kisha katolike "Zoja e Paperlyeme"
- ✓ Ujëvara e Hinkës

Qyteti i Apolonisë është themeluar në shek. VI para Krishtit nga kolonë të ardhur nga Korkyra dhe Korinthe në tokat e Taulantëve Ilirë. Kronikat e lashta dëshmojnë se midis 30 qyteteve të të gjithë botës antike që morën emrin për nder të Perëndisë Apolon, më e madhja dhe më e rëndësishmja ishte Apolonia e Ilirisë, që dikur strehonte rreth 60 000 banorë. Një vizitë e plote e qytetit të Apolonisë do të kërkonte të paktën një gjysmë dite, për të parë me radhë të gjitha monumentet arkeologjike të këtij qyteti me jete e histori 1000 vjeçare. Shpërndarja e tyre në një territor mjaft të gjere e bën të pamundur një itinerar të vetëm, prandaj shpjegimin po e bëjmë në bazë të tri itinerareve të ndryshëm.

Persa i perket qarkut Fier, ai përmban edhe një park tjetër arkeologjik, atë të Bylis.

Bylisi është një nga qendrat më të rëndësishme arkeologjike të Shqipërisë, renditur për nga vlerat monumentale. Bylisi ka qenë qyteti më i madh ilir në Ilirine e Jugut, dhe ka një pozite zoteruese mbi kodrat e Mallakastres dhe mbi luginën e Vjoses. Emri i tij përmendet relativisht vonë nga kronikat e kohës, në fillim del në trajtën Bulis në ngjarjet e viteve 49-48 p.Kr., kur ju dorëzua Cezarit dhe shërbeu si baze për furnizimin e ushtrisë së tij. Burimi më i hershëm për Bylisin është gjeografi grek Pseudo-Skylaksi 380 p.Kr. i cili shkruante: – "Oriket banojnë në krahinën e Amantisë, amantet që shtrihen deri këtu janë ilire nga bylinet", – duke lënë të kuptohet se lidhja midis amantëve dhe bylineve shpreh një bashkësi politike, një koinon.

Zona Gjeografike: Bashkia e re Fier kufizohet në veri me bashkinë Divjakë, në lindje me bashkitë Patos dhe Roskovec, ndërsa në jug me bashkinë Vlorë. Ajo shtrihet në Ultësirën Perëndimore, mes lumenjve Seman dhe Vlorë. Pjesa dërrmuese e bashkisë së re shtrihet në zonë fushore të ulët ndërsa komunat Cakran dhe Frakull kanë territor kodrinor. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Fierit.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011 në territorin e bashkisë së re banojnë 120.655 njerëz ndërsa në regjistrin civil rezultojnë banorë 196.324 njerëz. Sipërfaqja e bashkisë së re është 619.9 km². Në bazë të censurit, densiteti i popullsisë është 194.6 banorë për kilometër katror ndërsa në bazë të regjistrit civil, densiteti është 316.70 banorë/km².

Të dhëna të tjera: Bashkia e Fierit përfshin zonat bujqësore më të rëndësishme të vendit, si dhe një pjesë të konsiderueshme të industrisë që lidhet me përpunimin e naftës. Më shumë se 55 për qind e popullsisë së bashkisë së re jetojnë në zonat rurale, gjë që tregon rëndësinë e sektorit të bujqësisë në jetën ekonomike të bashkisë së re. Prodhimi bujqësor i kësaj zone është i shumëllojshëm nga drithi të zarzavatet, bostanoret, blegtoria dhe nënproduktet e saj. Bashkia e re do të ketë një vijë bregdetare të konsiderueshme që shtrihet nga grykëderdhja e lumit Vjosë deri në grykëderdhjen e lumit Seman në kufijtë e parkut kombëtar Divjakë-Karavasta.

Shfrytëzimi i bregdetit për turizëm është ende në fillesat e veta. Njësitë administrative Topojë dhe Dërmenas kanë një vijë bregdetare ranore prej 30 kilometrash, e gjitha shumë e përshtatshme për turizmin familjar.

Rrethi i Fierit ofron dhe potenciale të rëndësishme natyrore për zhvillimin e tij. Në përgjithësi kemi të bëjmë me një rajon fushor me lartësi nga 1–100 m mbi nivelin e detit dhe me toka shumë pjellore. Edhe relievet kodrinore janë përgjithësisht të buta dhe të mundshme për shfrytëzim bujqësor. Në zonat e rrafshëta zhvillohen tokat e hirta kafe. Kemi edhe lloje të veçanta tokash si aluvionale që takohen në luginat e Semanit e Vjosës, tokat e kripura që shtrihen në Hoxhare si dhe tokat moçalishte të Roskovecit. Në rrethin e Fierit shtrihet një pjesë e Myzeqeje së Madhe, Myzeqeja e Vogël dhe fushat e Frakullës e të Cakranit.

- **Karakteristikat klimaterike të zonës**

Fieri ashtu si e gjithë Shqipëria bën pjesë në brezin e klimës mesdhetare, dhe dallohet për tipare më të shprehura mesdhetare, e cila karakterizohet nga vera e nxehtë dhe e thatë me shkëlqim të madh të diellit dhe dimër i butë dhe me rreshje të mëdha. Ngricat dhe dëborat janë dukuri tepër të rralla. I nxehti fillon që prej mesit të pranverës dhe vazhdon deri në fund të tetorit. Klima e Fierit është e ngrohtë sepse Fieri laget nga deti dhe është i mbrojtur nga lindja prej erërave të ftohta. Fieri dallohet për numrin e lartë të ditëve me diell, mesatarisht 2800 ore në vit. Rreshjet kanë regjim kohor shumë të çrregullt ato janë përqendruar kryesisht në gjysmën e ftohtë të vitit, sasia mesatare e tyre arrin 980–1000 mm/vit.

Vera në Fier është e thatë dhe shpesh nuk bie shi për javë të tëra. Muajt më të lagësht janë nëntori dhe janari, kurse muajt më të thatë korriku dhe gushti. Erërat fryjnë në drejtime të ndryshme por gjatë dimrit mbizotëron era e jugut, e cila sjell edhe rreshje të mëdha, ndërsa gjatë verës era fryn nga veriu dhe veriperëndimi. Afërsia me detin bën që klima të jetë e butë dhe vetëm në raste tepër të rralla temperaturat të bien nën zero. Temperatura mesatare vjetore lëkundet nga 15°C-16°C.

Klima e Fierit lejon zhvillimin e një bujqësie shumë degëshe. Gjithashtu tokat bujqësore mund të shfrytëzohen 2-3 herë në vit. Në kuadrin e pasurive natyrore rëndësi të veçantë kanë pasuritë ujore, ku përveç detit Adriatik, rrethi përshkohet nga lumenjtë Seman, Vjosë e Gjanica.

Temperatura

Temperatura mesatare vjetore luhetet në 14-15 °C ndërsa temperatura e Janarit rreth 5 °C. Rreshjet bien kryesisht në formë shiu ndërsa dëborat është dukuri e rrallë. Gjatë verës bien vetëm 1/10 e

reshjeve vjetore gjë që shtron nevojën e ujitjes së tokave bujqësore. Për këtë arsye janë ndërtuar disa liqene artificiale si ujëmbledhësi i Zharrzës, Lalarit, etj.

Ndertimi gjeologjik

Depozitimet molasike të Tortonianit i përkasin periudhës së vonshme gjeosinklinale. Këto depozitime janë të përhapura në të gjithë ultësirën pranë Adriatike dhe përfaqësohen nga argjila e alevrolitë me ndërthurje ranorësh dhe me përmbajtje naftë e gazi (Marinëz Patos). Depozitimet molasike Miocen i sipërm (N_1^3) janë të përbëra nga argjila ranore dhe shtresa gëlqerorësh litotamnik (Karbunarë), por këta shkëmbinj janë të përhapur dhe në zonën e Patosit

Hidrokarburet

Vendburimi i naftës Patos shtrihet në pjesën më jugore të monoklinalit të Patos –Marinëz, në depozitimet molasike. Ky vendburim është i lidhur tërësisht me suitën Driza, që shtrihet stratigrafisht mbi suitën Marinza. Trashësia e ranorëve arrin 5 – 7 m deri 10 – 12 m e madje deri në 20 -25 m. Të gjitha shtratimet janë naftë me gaz të tretur, ku nafta është viskoze e tipit të naftave asfaltene të rënda. Është naftë e biodegraduar asfalto - rrëshinore, me përqindje të lartë squfuri që arrin deri në 6 %. Gazi është yndyror me përmbajtje të lartë metani deri në 85%. Në vendburimin PatosMarinëz janë shpuar afërsisht 3000 puse, 17 rajon që disponon rezervat gjeologjike më të mëdha në Evropë.

Semani - 281 km i gjatë formohet nga bashkimi i Devollit me Osumin në afërsi të Beratit. Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës është 5949 km², prurja mesatare vjetore e tij arrin në 96 m³/sek. Semani është ndër lumenjtë më eroziv, duke e bërë lumin me eroziv në vend. Vjosa - 272 km i gjatë buron nga malet e Pindit në Greqi. Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës është 6700 km², ndërsa prurja mesatare vjetore e tij arrin 195 m³/sek.


Gjanica - 67 km buron nga burimet e Poçemit e të Kalivaçit. Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës është 234 km². Është një nga lumenjtë më të ndotur në vend, për shkak të derdhjes së naftës. Rrethi ka edhe disa liqene artificiale ku më i madhi e më i rëndësishmi prej tyre është ai i Kurjanit me sipërfaqe 375 ha, ujërat e tij përdoren për ujitje.

Bota natyrore bimore dhe shtazore e rrethit është transformuar nga veprimtaria e njeriut. Megjithatë rrethi i Fierit dallohet për disa lloje bimësh e kafshësh sidomos në pjesët bregdetare e fushore. Takohen disa lloje kafshësh si urithi, çakalli, nusja e lalës, dhelpra, shkurtëza, mëllenja, thëllëza e fushës si dhe disa lloje të ndryshëm zvarranikësh e gjarpërinjsh. Ndërsa në ujërat e detit gjenden shumë lloje peshqish si qefulli, levreku, koca etj. Rrethi i Fierit bën pjesë në brezin e shkurreve dhe të pyjeve mesdhetare. Shkurret përbëhen nga nënkati i makies, ku rriten shkurret me gjelbërim të përhershëm si mareja, shqopa, gjineshtra, dafina. Në këtë nënkat bimor rriten edhe disa drurë të lartë si selvia, valanidhi, pisha e butë dhe e egër, që në disa raste formojnë pyje të vegjël.

Nëntoka është mjaft e pasur me lëndë djegëse siç janë gazi natyror dhe nafta ku dallohet zona e Patos-Marinëzës, e cila është dhe zona naftëmbajtëse më e madhe në Shqipëri. Gjithashtu nëntoka është e pasur edhe me materiale ndërtimi si zhavore, rërëra, argjila etj.


DISTANCA NGA ZONAT E MBROJTURA

Subjekti ndodhet 14.47 km nga zona e mbrojtur e Divjake-Karavasta



Rrethi i Fierit është një nga rrethet ku shoqëria njerëzore ka dëmtuar botën e gjallë me ndotjen mjaft të madhe të ajrit. Në të bëjnë pjesë disa zona të nxehta mjedisore si : fusha naftënxjerrëse Marinëz-Patos, Rafineria e Naftës Ballsh, AZOTIKU. Këto zona kanë sjellë ndotjen e dy lumenjve Gjanica dhe Seman, ujërave nëntokësore dhe në kombinim me automjetet e transportit, që çlirojnë një numër të madh gazrash, pluhuri dhe blözë, si dhe kanë bërë që Fieri të ketë një ajër tepër të ndotur mbi normat e lejuara. Një nga problemet kryesore është edhe eliminimi i 850 m³ me tretësire arseniti dhe arsenati tepër helmues që ndodhen në Uzinën e Plehrave Azotike.


HARTA TOPOGRAFIKE






Subjekti ndodhet 1.69 km nga burimi ujor me i afert i lumit Seman
ç. Skicat dhe planimetrite e objekteve te projektit dhe strukturave te projektit

Skica te djegesit






INCINERATOR WITH ONE BURNER TYPE 735



ΑΠΟΤΕΦΡΩΤΙΚΟΣ ΚΛΙΒΑΝΟΣ ΜΕ ΔΥΟ ΚΑΥΣΤΗΡΕΣ ΤΥΠΟΣ 1210
INCINERATOR WITH TWO BURNERS TYPE 1210



- d. Pershkrim i proceseve ndertimore dhe teknologjike perfshire kapacitetin prodhues, sasite e lendeve te para dhe produktet perfundimtare te projektit.

Përshkrimi i këtij aktiviteti është si më poshtë:

- Furnizimi manual. Pas djegies së disa tufave, hiri duhet të hiqet një herë në ditë.
- Djegesi është i pajisur me një pas-djegës të për të siguruar funksionimin pa tym dhe pa erë të keqe.
- Vendi i djegies, pas-djegësi dhe oxhaku janë të veshur me tulla zjarri me një shtresë izoluese të cilësisë së lartë, rezistente dhe të forta , të cilat mbahen në disa vende nga grepa metalike aliazhi që duron në temperatura të larta.

Djegie perfekte e karkasave të kafsheve

◆ Dhoma horizontale e djegies, ku flakët kalojnë mbi trupat e kafshëve në vend që të kalojnë nga poshtë lart, rezulton në një djegie më të pastër dhe më të plotë. Flaka në formë spirale rrit kohën e djegies duke rezultuar në një djegie më të pastër dhe më të plotë.

Plotësisht automatike

Ndezja automatike. Përdoruesi mbush djegesin, vendos kohëmatësin dhe largohet.

Asgjesim pa ndotje mjedisore.

Përputhet plotësisht me rregulloret. Nuk lëshohen erëra të pakëndshme ose tym gjatë djegies nëse funksionimi është normal. Redukton 100 kg kafshësh të ngordhura në më pak se tre kg hi.

Konstruksion i rëndë

Prodhuar nga llamarina e përforcuar me trashësi 10 mm për djegie afatgjatë. Cilindri i armatosur me shufra 10x20 mm për jetë më të gjatë. Saldimi i veçantë kompakt parandalon shpëputjen në pikat kritike.

- Përforcimi i veçantë i mureve rrit jetëgjatësinë si dhe djegien më efikase.
- Përfshihen kundërpesha dhe guarnicioni i derës janë të përfshira.
- Djeges i veshur me tulla zjarri rezistente në temperaturë prej 2500°C

Specifikimet Teknike

- Me rregullim elektronik të temperaturës 0^o-1400^oC
- Fuqia pas- djegësit 200 kcal/orë.
- Ventilatori, fuqia 70 m³/orë
- Lidhja elektrike 220V, 50Hz-20 Amp
- Karburanti: Vaj
- LLOJI 735

Kapaciteti për tufë 400 kg

- LLOJI 1210

Kapaciteti për tufë 1300 kg.

Koha e djegies për tufë 5 orë.

- Djegesit funksionojnë të kontrolluar në mënyrë termostatike, si një furrë e zakonshme. Kur temperatura brenda dhomës arrin nivelin e dëshiruar, djegësi fiket dhe më pas futet ajri në dhomë në mënyrë që kafsha e ngordhur të vazhdojë të digjet. Ky sistem unik i kontrollit të nxehtësisë kursen deri në 65% në konsumin e karburantit duke rezultuar në kursime mbi 4 litra naftë në orë. Ky është djegesi më i avancuar për sa i përket trajtimit të mbetjeve edhe tek rasti i mbetjeve nga kafshët.

Kontroll automatik –Operacioni bëhet i thjeshtë nga sekuenca e kontrollit plotësisht automatik. Një kontrollues i temperaturës mikroprocesor, me një lexim dixhital, siguron një kontroll optimal ndërsa siguron konsumin më të ulët të karburantit. Verifikimi vizual i çdo faze është dhënë në panelin e kontrollit. Tejkalimi i operatorit arrihet nga ndryshimi i çelësit për kontrollin **gjysmë-manual**.

Kontrolli i ajrit për shume dhoma djegie– I gjithë procesi i djegies është përfunduar brenda dhomave të kontrolluara nga ajri, duke eliminuar djegien në hyrje, duke lejuar funksionimin 24 orë, dhe duke siguruar një efikasitet më të madh të lendes djegëse.


Sistemi i monitorimit dhe kontrollit të ndotjes – Ky sistem monitoron vazhdimisht gazet mbetëse për të parandaluar emetimet e dukshme. E integruar me sistemin automatik, kjo veçori i mundëson njësisë të bëjë automatikisht të gjitha rregullimet e nevojshme.

Një izolues linear prej 75cm është siguruar si një tipar sigurie. Ndërsa gazet rrallë kalojnë 550°C, ky izolues zvogëlon penetrimin e nxehtësisë në çdo kusht, duke parandaluar mundësinë e zjarrit.

Zhurma e ulët – Ventilatori dytësor me djegie është prodhuar dhe instaluar për të lejuar funksionimin e zhurmës së ulët.

Ushqyes automatik (OPSIONALE) Djegesi është i pajisur me një ushqyes auto me tip kosh. Ushqyesi automatik është siç sugjeron emri krejtësisht i automatizuar, me operatorin që kërkohet vetëm për të ngarkuar kafshët apo mbeturine të tyre në ushqyes, ose në llojin kosh. Pasi të ngarkohet ushqyesi dhe të jetë angazhuar butoni i sigurisë, sistemi do të përcaktojë se kur duhet ushqyer. Kjo parandalon mbi ushqyerjen nga operatorët dhe rrit sigurinë rreth ushqyesit të inceneratorëve.

Ne përgjithësi skema principate e djegesave është e njëjtë. Edhe në rastin e djegies së kafshëve skema apo diagrama e punës është e njëjtë.



Ky subjekt eshte pajisur me Leje Mjedisi si me poshte:

LEJE

PN-1045-03-2022 Kodi: III.1.B () Data e lëshimit: 08/03/2022 Afati i vlefshmërisë: Pa afat	Nikos Semanjakos NUIS/NIPT: L03414401Q 15, FIER , , Fshati Sheqishte. Banesa te Grupi i Naftes.	Emërtimi përshkrues i veprimtarisë Leje Mjedisi Tipi B per Thertore. Kod tjetër:
Kategoria Për ndikimin në mjedis		Kufizime specifike <i>Leja ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi</i>
Nënkategoria Leje Mjedisi e tipit B		Detyrime specifike 1. Bashkangjitur akti i miratimit <i>Leja ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi</i>
Veprimtari specifike .		Vendi i kryerjes së veprimtarisë Qarku: Fier, Rrethi: FIER, B/K: Fier, Q/F: FIER, Adresa: Fier FIER Fier FIER Fier MBROSTAR URA MBROSTAR URA Fshati Mbrostar Ura, Rruga Fier- Kallm km 2, Ndertesa ZK 2636, nr pasurie 63/22.
Specialiteti		Nënshkrimi i sportelit:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT



MINISTRI

MIRELA KUMBARO-FURXHI

Nr. 7387/ Prot

Datë 15.12.2023

Nr.i identifikimit të Lejes 3946

K.Nr.111

**AKT – MIRATIM
LEJE MJEDISI TIPI B**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, Ligjit Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, dhe në zbatim të tyre, pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit jep mendimin për miratimin e lejes me argumentimet bashkëngjitur për kërkuesin si më poshtë.

1. Person fizik: Nikos Semanjakos (LC – 1376)

1.2 NUIS: L03414401Q

1.3 Adresa: Qarku Fier, Bashkia Fier, Njësia Administrative, Fshati Sheqishte, Banesa te grupi i Grupi i Naftës, Nr. 1/1.

1.4 Personi përgjegjës: Nikos Semanjakos

2.1 Titulli i instalimit: Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to.

2.2 Përshkrimi i veprimtarisë dhe kapacitetit prodhues: I.D 7.7/a Thertore. Kapaciteti prodhues është 50ton/ditë ose më pak se kaq, por gjithësesi më shumë se 2 ton/ditë. Sipërfaqe Totale 7216m² nga ku sipërfaqe e zënë nga struktura 1120m² Zona Kadastrale 2636

Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr. 4, Tiranë, - Tel/Fax 04 2 371 237 - www.akm.gov.al

1

Pra nuk do te kemi ndertim objekti nga e para, hapje themelesh, germime dherash, gjenerim mbetjesh inerte, ngritje muresh etj.

Do te behet vetem montimi ne toke i inceneratorit, sipas skices se mesiperme, I cili do te mbulohet me nje strehe konstruksion metalik dhe tjegulla zjarrdruese.

- e. Infrastruktura e nevojshme per lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me uje, shkarkimet e ujerave te ndotura dhe mbetjeve si dhe informacion per rruget ekzistuese te aksesit apo nevojën per hapje te rrugeve te reja**

Per sa i perket infrastruktures se jashtme, duke qene se faza e ndertimit ka perfunduar, per zhvillimin e aktivitetit te incenerimit te mbetjeve te kafsheve e gjithë infrastruktura eshte gati. Pra rruga per ne objekt eshte e shtruar, jane kryer te gjitha lidhjet per rrjetin elektrik, ujerat e bardha dhe te zeza, jane lidhur kontratat per largimin e mbetjeve. Mbetet vetem instalimi i inceneratorit dhe fillimi i aktivitetit.

- f. Programi per ndertimin, kohezgjatjen e ndertimit, kohezgjatjen e planifikuar te funksionimit te projektit, kohen e mundshme te perfundimit te funksionimit te projektit dhe sipas rastit edhe fazen e planifikuar te rehabilitimit te siperfaqes pas mbarimit te funksionimit te projektit**

Per sa i perket fazes se ndertimit, theksojme se kapanonet jane te ngritura. Pritet vetem te mbarojne procedurat qe kane lidhje me vleresimin e ndikimit ne mjedis, per fazen e instalimit dhe menjehere do te instalohen te gjitha pajisjet e siperpermendura. Faza e instalimit te pajisjeve, pra montimi, venia ne prove, testimi do te zgjase perreth 1 muaj.

- g. Menyrat dhe metodat qe do te perdoren per ndertimin e objekteve te projektit**

Kjo pjese e kapitullit nuk trajtohet, pasi kapanonet jane te montuara.

- h. Lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyrën e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji)**

Kjo pjese e kapitullit nuk trajtohet, pasi kapanonet jane te montuara.

- i. Informacion per lidhjet e mundshme te projektit me projekte te tjera ekzistuese perreth/prane zones te projektit**

Aktiviteti zhvillohet ne nje zone me karakter agraro-blegtoral. Ky projekt do te kete lidhje me projektet ekzistuese perreth, per arsyt si me poshte:

- lenda e pare do te merret direkt nga linja e prodhimit te vete kompanise duke kursyer shpenzimet;
- mund edhe te lihte kontrata me subjekte te tjera per te trajtuar mbetjet e kafsheve me incenerim.

- j. Informacion lidhur me alternativat e marra ne konsiderate persai takon perzgjedhjes se vendodhjes se projektit dhe teknologjise qe do perdoret**

Arsyeja kryesore se perse investohet per kete objekt, eshte pike se pari, se aktiviteti do te zhvillohet mbi nje truall ne pronesi te investitorit, ne nje objekt tashme te ndertuar.

Duke pare kerkesat ne rritje te tregut vendas per produktet bio, kushtet e pershtatshme klimaterike, pa e arsyeshme qe te investohej ne kete linje per zgjerimin e aktiviteve aktuale.

Gjithashtu, ky aktivitet, zhvillohet duke ruajtur tiparet e ekonomise se zones, ku si edhe u theksua me lart, eshte ai me karakter bujqesor. Nga aktiviteti I perditshem I shoqerise gjenerohen mbetje kafshesh te cilat investitori e ka para me te leverdishme qe t'I trajtoje vete, duke eliminuar kostot me kontratat me te tjere.

k. Perdorimin e lendeve te para gjate funksionimit, perfshire sasite e ujit te nevojshme, energjise, lendeve djegese dhe menyren e sigurimit te tyre

Për funksionimin e instalimit do të përdoren lëndët e para si më poshtë:

- Makineri/pajisje (për mirëmbajtjen);
- Ujë teknologjik dhe sanitar (për punonjësit);
- Energji Elektrike (për mbarëvajtjen e aparaturave);
- Mjete transporti;
- Karburant dhe lubrifikant për mjetet e transportit.

Per kete lloj aktiviteti nevojiten uje dhe energji elektrike 24 ore pa ndalim, lenda e pare mbetje kafshesh nga aktiviteti i thertores.

l.Aktivite te tjera qe mund te nevojiten per zbatimin e projektit, si ndertim i kampeve apo rezidencave etj.

Nuk nevojiten aktivite te tjera. Stafi do te punesohet nga banore residente te zones.

m.Informacion per lejet dhe licensat e nevojshme per projektin te kerkuara nga legjislacioni ne fuqi si dhe institucionet kompetente per lejimin/licensimin e projektit

Pas perfundimit te fazes se njoftimit, zhvilluesi kryen degjese me publikun dhe aplikon me pas per VNM te Thellur.

k. kopje te lejeve, autorizimeve dhe licencave qe disponon zhvilluesi per projektin e propozuar, ne perputhje me percaktimet e bera ne legjislacionin ne fuqi, si dhe institucionet kompetente per lejimin/autorizimin/licencimin e projektit.

Shkresa e AKM / Leje Mjedisi Tipi B/ Certificate prone / Ekstrakt QKB, bashkelidhur raportit teknik.

SHKRESA NGA AKM PER VNM TE THELLUAR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E LEJEVE MJEDISORE DHE VNM

Nr. 1311 Prot.

Tiranë, më: 12.02 2024

Lënda: Informacion mbi procedurat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

“NIKOS SEMANJAKOS” ✓

Fier, Zharëz, Sheqishtë, Fshati Sheqishte, Banesa te grupi i naftës. L03414401Q.

Në përgjigje suajës, me Nr. Extra Prot., datë 07.02.2024, regjistruar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit me Nr. 1311 Prot., datë 07.02.2024 lënda “Kërkesë për informacion mbi VNM Paraprake.”, ju bëjmë me dije se:

Në bazë të Ligjit nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, projekti “Incinierimi i mbetjeve duke përfshirë mbetjet e kafshëve në një instalim incinerimi”, përfshihet në *Shtojcën I: Pika 9. Instalime për asgjësimin e mbetjeve për incinerimin, trajtimin kimik, sipas seksionit D9, ose venddepozitimet e mbetjeve të rrezikshme, siç përcaktohet në ligjin “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”*, duhet ti nënshtrohet procedurës së VNM-së.

Aplikimi kryhen në platformën qeveritare “e-Albania”, bazuar në VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjësive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar;

Duke Ju falenderuar,

DREJTORI PËRGJITHSHËM



LEJE MJEDISI E TIPIT B

LEJE

PN-1045-03-2022	Nikos Semanjakos	Emërtimi përshkrues i veprimtarisë Leje Mjedisi Tipi B per Thertore.	
Kodi: III.1.B ()	NUIS/NIPT: L03414401Q		Kod tjetër:
Data e lëshimit: 08/03/2022	15, FIER , , Fshati Sheqishte. Banesa te Grupi i Naftes.		Kufizime specifike <i>Leja ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi</i>
Afati i vlefshmërisë: Pa afat			Detyrime specifike 1. Bashkangjitur akti i miratimit <i>Leja ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi</i>
Kategoria Për ndikimin në mjedis		Vendi i kryerjes së veprimtarisë Qarku: Fier, Rrethi: FIER, B/K: Fier, Q/F: FIER, Adresa: Fier FIER Fier FIER Fier MBROSTAR URA MBROSTAR URA Fshati Mbrostar Ura, Rruga Fier- Kallm km 2, Ndertesa ZK 2636,nr pasurie 63/22.	
Nënkategoria Leje Mjedisi e tipit B		Nënshkrimi i sportelit: _____	
Veprimtari specifike .			
Specialiteti			



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT



MINISTRI

MIRELA KUMBARO-FURXHI

Nr. 7387/1 Prot

Datë 15.12.2023

Nr.i identifikimit të Lejes 3946

K.Nr.111

**AKT – MIRATIM
LEJE MJEDISI TIPI B**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, Ligjit Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, dhe në zbatim të tyre, pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit jep mendimin për miratimin e lejes me argumentimet bashkëngjitur për kërkuuesin si më poshtë.

1. Person fizik: Nikos Semanjakos (LC – 1376)

1.2 NUIS: L03414401Q

1.3 Adresa: Qarku Fier, Bashkia Fier, Njësia Administrative, Fshati Sheqishte, Banesa te grupi i Grupi i Naftës, Nr. 1/1.

1.4 Personi përgjegjës: Nikos Semanjakos

2.1 Titulli i instalimit: Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to.

2.2 Përshkrimi i veprimtarisë dhe kapacitetit prodhues: I.D 7.7/a Thertore. Kapaciteti prodhues është 50ton/ditë ose më pak se kaq, por gjithësesi më shumë se 2 ton/ditë. Sipërfaqe Totale 7216m² nga ku sipërfaqe e zënë nga struktura 1120m² Zona Kadastrale 2636

CERTIFIKATE PRONE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI PRONËSIE

PRONARI/BASHKËPRONARËT		
Emri i Personit Juridik	Nr. Personal NIPT	Pjesa(-/-)
Nikos Semanjakos	L03414401Q	1/1

Numri i Pasurisë	63/22-ND		
Kodi Unik	2636017115		
Zona Kadastrale	2636		
Lloji i Pasurisë	NDERTESE		
Sipërfaqja e pasurisë (m2)	Totali: 1120	Truall: 0	Ndërtesë: 0
Vlera Aktuale e Pasurisë	1		
Adresa e Pasurisë	FIER, FIER, Rr.: MBROSTAR URA		

DREJTORI
Arben Voja

Arben
Voja

Digitally signed by:
Arben Voja
Date: 2022.06.30
05:13:49 +02'00'

Data e lëshimit 30/06/2022



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Fier
Date: 2022/06/30 17:00:23 +02'00'
L03414401Q2022063017001864L1014



Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
te një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)


Miturur me VKM N°3, Datë 07.10.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE

ZONA KADASTRALE: 2636
NUMRI PASURISË: 63/22ND

KODI UNIK:
INDEKSI HARTËS: K-34-112-180-5



SH 1: 2500

DREJTORI
ARBEN VOJA Data e leshimit 30/06/2022

Arben Voja
Digitally signed by Arben Voja
Date: 2022.06.30 09:20:43 +02'00'
Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Fier
Date: 2022/06/30 17:19:34 +02'00'
H0091443192022063017192671014

SHPJEGUES
□ PARCELA
■ NDËRTESA



Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

Nr. 2484/ 4 Prot.

Fier, më 30.04.2019

LEJE NDËRTIMI

I JEPET: NIKOS SEMANJAKOS DHE SONILA SEMANJAKOS

ZHVILLUESI: Personi Fizik "Nikos Semanjakos", me subjekt ndërtues
"AGBES KONSTRUKTION" SH.P.K.

I REGJISTRUAR SI SUBJEKT ME TË DHËNAT E MËPOSHTME:

Ekstrakt të lëshuar nga QKB, Fier, NUIS: K32807432W

Licensë ndërtimore: NZ.4452/10

LEJA E NDËRTIMIT PËR PUNIMET

"OBJEKT THERTORE I KAT"

ADRESA E REALIZIMIT TË PUNIMEVE: MBROSTAR URA, FIER

AFATI KOHOR I KËSAJ LEJE ËSHTË DERI NË DATËN: 30.04.2021

Leja e ndërtimit jepet me këto kushte:

1. Të respektohet destinacioni i zhvillimit për ndërtimin e strukturës, si dhe treguesit e zhvillimit;
2. Të respektohet radha e punimeve sipas projektit të miratuar dhe grafikut të punimeve;
3. Të rrethohet zona ku ndërtohet dhe të mbahet pastër mjedisi përreth;
4. Për çdo ndërhyrje në rrjetin e infrastrukturës publike, sipas projektit të miratuar të kontaktohet me institucionet përkatëse, në mënyrë që të mos krijohen shqetësime në rrjetin publik;
5. Të respektohen normat dhe standardet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi mbi kryerjen e punimeve dhe sigurinë në punë;
6. Gjatë zbatimit të punimeve objekti do të kontrollohet nga autotitetet e Kontrollit të Zhvillimit dhe Inspektoriati Ndërtimor pranë njësisë vendore përkatëse;
7. Në shkelje të kushteve ligjore të kësaj leje do të merren masa konform ligjit deri në prishje të saj dhe/ose të strukturës.
8. Afati i fillimit të punimeve është **1 (një) vit** nga data e lëshimit të kësaj leje;
9. Kjo leje është e vlefshme për një periudhë **24 (njëzet e katër) muaj** nga data e lëshimit të saj, referuar grafikut të punimeve bashkangjitur

Data e miratimit të lejes: **30.04.2019**

KRYETARI

Armando SUBASHI

Armando Subashi

Digitally signed by Armando Subashi
Date: 2019.04.30 13:54:19 +02'00'



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
BASHKIA FIER

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

Nr. 2484/ 3 Prot.

Fier, më 30.04.2019

VENDIM
Nr. 142 , datë 30.04.2019

Për miratimin e lejes së ndërtimit:
"OBJEKT THERTORE I KAT"

Në zbatim të nenit 39 dhe 46 të ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; nenit 22 dhe 23 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.408,dt. 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; dhe ligjit nr. 139/2015, dt. 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", si dhe në bazë të raportit të vlerësimit teknik:

VENDOSA :

1. Miratimin Lejes së Ndërtimit të objektit " Objekt thertore I kat", në adresen: "Mbrotar-Ura", Fier, me pronar Nikos Semanjakos dhe Sonila Semanjakos, zhvillues Person Fizik: "Nikos Semanjakos"; me subjekt ndërtues "AGBES KONSTRUKTION" shpk, me vlerë të taksës së ndikimit në infrastrukturë 805.752'34 lekë.
2. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë!

Konceptoi:
Drejtor i Planifikimit
dhe Zhvillimit të Territorit
Adela HYSENAJ

Adela Hysenaj Digitally signed by Adela Hysenaj
Date: 2019.04.30 13:46:27 +0200

KRYETARI
ARMANDO SUBASHI
Armando Subashi Digitally signed by Armando Subashi
Date: 2019.04.30 13:45:12 +0200

PLANI I VENDOSJES PËR STRUKTURËN: "OBJEKTI, THËRTORE 1 KATE"
 ADRESA: NJESIA ADMINISTRATIVE MBROSTAR, FSHATI MBROSTAR-URA, FIER
 PRONAR: NIKOS SEMANJAKOS, SONILA SEMANJAKOS
 ZHVILLUES: PERSON FIZIK "NIKOS SEMANJAKOS" NIPT: L034144001Q
 SUBJEKTI NDERTUES: "AGBES KONSTRUKSION"
 SIPERFAQJA E TOKES QË ZHVILLOHET 7216m²

Digitally signed by
 Armando Subashi
 DN: cn=Armando Subashi,
 ou=Digitally Signed
 Date: 2019.04.30 13:55:06 +0200

MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISË FIER
 Armando Subashi Digitally signed by Armando Subashi
 Date: 2019.04.30 13:55:06 +0200
ARMANDO SUBASHI

EMERTIMI I PUNIMEVE: OBJEKTI THËRTORE 1 KATE
 KATEGORIA E PËRDORIMIT TË TOKËS: BUJQESI
 LLOJI I STRUKTURËS: KONSTRUKSION METALIK ME MBULESE ME SANDUIC
 PRONARI I TOKËS: NIKOS SEMANJAKOS
 ADRESA: NJESIA ADMINISTRATIVE MBROSTAR, FSHATI MBROSTAR, FIER
 KODI I NËNNJËSISË STRUKTURORE: 1150
 KODI I PËRDORIMIT SIPAS PLANIT: 774
 ZHVILLUES: PERSON FIZIK "NIKOS SEMANJAKOS" NIPT: L034144001Q
 SUBJEKTI NDERTUES: AGBES KONSTRUKSION

TREGUESIT E ZHVILLIMIT TË PROPOZUAR	
SIP. E TOKES QË ZHVILLOHET	7216
SIP. E TOKES E ZËNË NGA STRUKTURA	1120
SIP. E PËRGJITHSHMË E NDËRTIMIT	1120
LARTËSIA MAKSIMALE E STRUKTURËS NGA NIVELI I TOKËS	6.45
NUMRI I KATEVE MBI TOKË	1
NUMRI I KATEVE NËN TOKË	0
NUMRI I VENDPARKIMEVE TE AUTOMIETEVE	22

TREGUESIT E DISTANCAVE	
NGA KUFIJTE E PRONËS	V:20.1 J:28.1 L:20.2 P:25
NGA STRUKTURAT E TJERA:	V:- J:- L:- P:-
NGA RRËZET BRUGOR:	V:- J:- L:- P:30.5
NGA SERVLUTET PUBLIKE:	V:- J:- L:- P:30.5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 BASHKIA FIER
 DREKTORIA E PËRGJITHSHMË E PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT
 Departamenti i Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit
 Specialist i Geo-Kadastrës
 Specialist i Aplikimeve

Ing. Adela Hysenaj
 Ing. Mimoza Kola
 Ing. Sebahar Bili
 Ark. Enjella Myrta
 Ing. Gezim Hazazi

Ekstrakt QKB



EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTI "PERSON FIZIK"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	L03414401Q
2. Emri i subjektit	Nikos Semanjakos
3. Forma ligjore	Person Fizik
4. Data e regjistrimit	14/10/2010
5. Fusha e veprimtarisë	Magazinin, përpunim imputesh bujqesore e biegtorale si dhe rritje e tregtim shpende e kafshe te gjalla me shumice dhe me pakice. Thërje, përpunim dhe tregtim të produkteve të mishit, përpunim lëkurash dhe eksporti i tyre. Transporti rrugor kombëtar dhe nderkombëtar i mallrave për vete, për të tretë dhe me qira. Shitje me shumice e ushqimeve me origjine shtazore për mjëzër. Mbarështimi i kafshëve për majmëri. Bar kafe, restorant. Shitje me pakice. Tregti me pakice dhe shumice e mishit të ngjirë. Transporti i lendeve të rrezikshme për veten e vete.
6. Vendi i ushtrimit të aktivitetit	Fier ZHAREZ SHEQISHTE Fshati Sheqishte. Banesa te Grupi i Naftes.
7. Vende te tjera të ushtrimit të aktivitetit	Fier ZHAREZ SHEQISHTE Automjeti me targe AA 288 SG Fier ZHAREZ SHEQISHTE Mjeti me targe AB 425 CD Fier ZHAREZ SHEQISHTE Automjeti me targe AA 683 IL Fier ZHAREZ SHEQISHTE Mjeti me targe AA 672 TY Fier ZHAREZ SHEQISHTE Mjeti me targe AA 671 TY Fier ZHAREZ SHEQISHTE Mjeti frigorifer me targe AA 198 NA Fier ZHAREZ SHEQISHTE Gjysem rimorkio me targe AER 374 Fier ZHAREZ SHEQISHTE Mjeti me targe AB 967 CM Fier ZHAREZ SHEQISHTE AA 960 DS Fier ZHAREZ SHEQISHTE Mjeti me targe AA408 KP Fier ZHAREZ SHEQISHTE Mjeti me targe AA 755 XT Fier MBROSTAR URA MBROSTAR URA Fshati Mbrostar Ura, Rruga Fier- Kallm km 2, Ndertesa ZK 2636.